



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



## DREJTORIA E ARSIMIT

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-032), Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Nr. 04/L-138), Udhëzimin Administrativ të MASHTI-it (Nr. 22/2013) për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës, dokumentin nga MASHTI (Nr. 3/2838, datë 29.06.2026).

## KONKURS

**Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale (Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional, IAAP) për vitin shkollor 2026-2027, sipas Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KKK).**

### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në Gjimnazin "17 Shkurti" në Obiliq dhe SHMLP "Ismail Dumoshi" në Obiliq për vitin shkollor 2026-2027, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit që e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Republikës së Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen (nostrifikimin) e certifikatave ose dëftesave në MASHTI përpara se të konkurrojnë.

### 2. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Nxënësit duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën ku konkurrohet)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (klasat 6-9)
- Certifikatën e lindjes

### 3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

- **Dorëzimi i dokumenteve:** Bëhet më datat 7, 8 dhe 9 korrik 2026, në lokalet e shkollës përkatëse, nga ora 08:00 deri në 16:00.
- **Shpallja e rezultateve:** Rezultatet do të shpallen në shkollat përkatëse më 10.07.2026.

- **Kthimi i dokumenteve:** Për nxënësit që nuk janë pranuar, kthimi i dokumenteve bëhet nga data 13.07.2026.
- **Afati për ankesa:** Nxënësi i pakënaqur ka të drejtë ankese brenda **(2) dy ditë pune** nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesa e shkallës së parë parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesa e shkallës së dytë bëhet në Drejtorinë e Arsimit brenda (2) dy ditë pune pas pranimi të përgjigjes nga shkolla.

## A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi maksimalisht mund të fitojë **100 pikë (100%)**, të cilat ndahen si vijon:

- |                                            |                         |
|--------------------------------------------|-------------------------|
| 1. <b>Suksesi nga shkollimi i obliguar</b> | 40% (maksimumi 40 pikë) |
| 2. <b>Suksesi nga lëndët prioritare</b>    | 20% (maksimumi 20 pikë) |
| 3. <b>Numri i pikëve nga testi</b>         | 40% (maksimumi 40 pikë) |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%), 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë së paku 4.00 (llogaritet mesatarja e lëndës për klasat 6-9, e pastaj mesatarja e përgjithshme e atyre lëndëve). Kriteri i lëndëve prioritare nga testi është minimumi 40% e pikëve nga ato lëndë.

Nxënësi nga suksesi I përgjithshëm I shkollimit të obligueshëm (kl.6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksesi(kl.6+kl.7+kl.8+kl.9)} \times 2 = 40 \text{ pikë maksimum}$$

Nxënësi nga suksesi I përgjithshëm I lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.

$$\text{Mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = 20 pikë maksimum}$$

- **Lëndët me përparësi sipas drejtimeve:**

- Gjimnazi i Shkencave Natyrore:** Fizikë, kimi, biologji dhe matematikë
- Gjimnazi i Shkencave Shoqërore dhe Gjuhësore:** Gjuhë amtare, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi

- **Lëndët me përparësi me sukses sipas profileve në IAAP :**

- Elektroteknikë, Xehitari, Kimi – Teknologji dhe Gjeologji: Matematikë, Informatikë, Fizikë, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi**

#### 4. Kriteri I suksesit të notave në lëndët me përparësi për drejtimet përkatëse

- Gjimnazi I shkencave natyrore: Mesatarja e lëndëve fizikë, kimi, biologji dhe matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër), si 40% të lëndëve prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)

$$\text{Mesatarja (kimi) + mes.biologji + mes.fizikë + mes.matematikë} > 4$$

- Gjimnazi i shkencave shoqërore: Mesatarja e lëndëve gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi, së paku duhet të jetë 4 (katër) si 40% të lëndëve prioritare në test (20 pikë nga lëndët: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi)

$$\text{Mes. (gjuhë shqipe) + mes.(gjuhë angleze) + mes.(histori) + mes.(gjeografi)} > 4$$

#### B. Përmbajta e testit: numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve

##### I.Gjuhë:

|                    |         |
|--------------------|---------|
| 1.Gjuhë shqipe     | 25 pikë |
| 2.Gjuhë angleze    | 5 pikë  |
| (Gjithsej 25 pikë) |         |

##### II. Shkencat shoqërore:

|                    |         |
|--------------------|---------|
| 1.Gjeografi        | 12 pikë |
| 2.Histori          | 13 pikë |
| (Gjithsej 25 pikë) |         |

##### III. Matematikë dhe Informatikë

|                    |         |
|--------------------|---------|
| 1.Matematikë       | 20 pikë |
| 2.Informatikë      | 5 pikë  |
| (Gjithsej 25 pikë) |         |

##### IV.Shkencat natyrore:

|                    |        |
|--------------------|--------|
| 1.Fizikë           | 8 pikë |
| 2.Kimi             | 8 pikë |
| 3.Biologji         | 9 pikë |
| (Gjithsej 25 pikë) |        |

## 5. Rënditja e lëndëve me prioritetet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

### I. Gjimnazi shkencat e natyrës:

1. Shkenca e natyrë – 25
2. Matematikë informatikë – 25
3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze – 25
4. Shkencat shoqërore – 25

$$\begin{aligned}25 \times 0.8 &= 20 \text{ pikë} \\25 \times 0.4 &= 10 \text{ pikë} \\25 \times 0.3 &= 7.5 \text{ pikë} \\25 \times 0.1 &= 2.5 \text{ pikë} \\ \text{Totali} &= 40 \text{ pikë}\end{aligned}$$

### II. Gjimnazi shoqëror:

1. Shkenca shoqërore – 25
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze – 25
3. Matematik dhe informatikë – 25
4. Shkencat natyrore – 25

$$\begin{aligned}25 \times 0.6 &= 15 \text{ pikë} \\25 \times 0.6 &= 15 \text{ pikë} \\25 \times 0.3 &= 7.5 \text{ pikë} \\25 \times 0.1 &= 2.5 \text{ pikë} \\ \text{Totali} &= 40 \text{ pikë}\end{aligned}$$

## 6. Rënditja e lëndëve me prioritetet sipas profileve në shkollën profesionale

### I. Makineri, Elektroteknikë, Xehtari, Gjeologji, Kimi – Teknologji

1. Matematikë dhe Informatikë – 25
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 25
3. Shkenca Natyrore – 25
4. Shkenca Shoqërore – 25

$$\begin{aligned}25 \times 0.8 &= 20 \text{ pikë} \\25 \times 0.4 &= 10 \text{ pikë} \\25 \times 0.3 &= 7.5 \text{ pikë} \\25 \times 0.1 &= 2.5 \text{ pikë} \\ \text{Totali} &= 40 \text{ pikë}\end{aligned}$$

### II. Ekonomi (Banka dhe Sigurime)

1. Matematikë dhe Informatikë – 25
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 25
3. Shkenca Natyrore – 25
4. Shkenca Shoqërore – 25

$$\begin{aligned}25 \times 0.8 &= 20 \text{ pikë} \\25 \times 0.4 &= 10 \text{ pikë} \\25 \times 0.3 &= 7.5 \text{ pikë} \\25 \times 0.1 &= 2.5 \text{ pikë} \\ \text{Totali} &= 40 \text{ pikë}\end{aligned}$$

## Gjimnazi “17 Shkurti” në Obiliq

| Nr.       | Drejtimi          | Numëri I paraleleve të planifikuara | Numëri I nxënsëve në afatin e Korrikut |
|-----------|-------------------|-------------------------------------|----------------------------------------|
| 1.        | Gjimnazi Natyror  | 2                                   | 64                                     |
| 2.        | Gjimnazi Shoqëror | 2                                   | 32                                     |
| Gjithsej: |                   | 3                                   | 96                                     |

## SHMLP “Ismail Dumoshi” në Obiliq

| Drejtimi          | Profili              | Nr.Paraleleve | Nr. I nxënsëve | Vitet e shkolimit |
|-------------------|----------------------|---------------|----------------|-------------------|
| Elektroteknikë    | Informatikë          | 1             | 24             | 2+1               |
| Elektroteknikë    | Energjetikë          | 1             | 24             | 2+1               |
| Kimi – Teknologji | Xehtari              | 1             | 24             | 2+1               |
| Kimi – Teknologji | Laborant I Kimisë    | 1             | 24             | 2+1               |
| Gjeologji         | Minatro              | 1             | 24             | 2+1               |
| Makineri          | Operator I prodhimit | 1             | 24             | 2+1               |
| Ekonomi           | Banka dhe Sigurime   | 1             | 24             | 2+1               |
|                   | Gjithsej:            | 7             | 168            |                   |

Drejtores e DA-së: Sevdije Berisha Krasniqi

